

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: "ILLYRIAN GUARD SH.A" dhe "KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK"
Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik,
shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

Armand Sinani "Person Fizik"

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L22301008D

Nuis/Nipt

Njesia Bashkiake Nr.9, Rruga "Jordan Misja", Kompleksi "Gener 2", Kati -1, Parkimi Nr.29, Tiranë
Adresa

Tiranë

Shqipëri

N/A

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

00355692090910

N/A

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

ar.en.sinani@gmail.com

E-mail

Armand Sinani (Administrator)

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/08/28

Data (viti/muaji/dita)

N/A

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

N/A

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)



Seksioni II. Informacion mbi procedurën

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

REF-77994-08-21-2023

2. Lloji i Procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.

Procedurë e hapur

Procedurë e hapur e thjeshtuar

Procedurë e kufizuar

Procedurë konkurruese me negociim

Partneritet për inovacion

Dialog konkurrues

Procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit

Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

Shërbim Konsulence

Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

ILLYRIAN GUARD SH.A

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

(Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)



2

4

15,810,000.00 Lekë (Pesëmbëdhjetë milion e tetëqind e dhjetë mijë) Lekë pa Tvsh

5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër
(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader).

“Kepeuce me qafa” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” ShA

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(Data (viti/muaji/dita)

2023/09/06

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

N/A

8. Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

N/A

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;

Vendimi nr. 285 datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e

Rregullavetë Prokurimit Publik”, i ndryshuar ;

Rekomandim Nr.6732 Prot, datë 21.10.2020 “Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të dokumenteve të tenderit dhe verifikimit të procedurave të prokurimit për mallra, punë, shërbime” i “Agjencisë së Prokurimit Publik”

Vendim Nr.32/2023 i “Komisionit të Prokurimit Publik”

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

X



- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkonti pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)



3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Në datën 22.08.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "E hapur" me objekt "Kepuce me qafa" për nevojat e shoqërisë "Illyrian Guard" ShA" me REF-77994-08-21-2023 me fond limit 15,810,000.00 Lekë pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 06.09.2023 nga autoriteti kontraktor "ILLYRIAN GUARD SH.A".

Shoqëria jonë shfaqet në cilësinë e shoqërisë të interesuar në furnizimin me mallrat e kërkuara nga autoriteti kontraktor, e për rrjedhojë kemi interes të drejtpërdrejtë për të marrë pjesë në procedurën e mësipërme të prokurimit. Pasi shqyrtuam dokumentet e procedurës së prokurimit, kriteret e vecanta të kualifikimit, specifikimet teknike të procedurës, gjykojmë se këto të fundit nuk janë hartuar në përputhje me ligjin "Për prokurimin Publik", dhe aktet nënligjore në zbatim të tij duke rënë ndesh me kuadrin ligjor në fuqi.

Për rrjedhojë, paraqesim ankesën si më poshtë vijon:



5

7

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

I. MBI LEGJITIMITETIN

Në nenin 110 pika 1, paragrafi 2 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet se: " 1.Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

-Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë."

Në nenin 94 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet se:

"1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedure prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

2. Operatori ekonomik ankimues duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

3. Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkeljes së pretenduar. Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që



vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.”

Sa më sipër, në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, interesi i të cilit rrezikon të dëmtohet për shkak të kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij gëzojnë legjitimitet të drejtëpërdrejtë dhe aktiv për të paraqitur ankesë në këtë procedurë prokurimi.

Bazuar në nenin 111, pika 1 e ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“1.Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën nëautoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.**

*Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”, ankesa është paraqitur njëkohësisht në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në zbatim të rregullave të parashikuara në ligjin 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij dhe brenda afatit 7 ditor nga data e publikimit të procedurës së prokurimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike **duke u legjitimuar.***



II. MBI ANKESËN

Pasi morëm në shqyrtim dokumentet e procedurës së prokurimit, kriteret e vecanta për kualifikim, si edhe specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi, konstatojmë se nga ana e autoritetit kontraktor janë kryer shkelje në drejtim të hartimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit duke rënë ndesh me ligjin 162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, duke vendosur kritere diskriminuese dhe të ekzagjeruara dhe rrjedhimisht duke sjellë si pasojë uljen e konkurrencës dhe të efikasitetit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

1. Në shtojcën 7 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se: "Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, OE duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se: Vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi."

Në nenin 2 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", parashikohet se:
"Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."



Në nenin 3 *“Parime të përgjithshme”* të ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 pika 1 *“Autoriteti ose enti kontraktor”* i ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, parashikohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.”*

Në nenin 77, pika 1 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”*, parashikohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar



kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, **kapacitetet ekonomike, financiare** dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, **përvojën e duhur**, si dhe personelin e nevojshëm, **gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës**. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim në varësi të volumit sidhe të natyrës së kontratës, me qëllimin e krijimit të një panorame sa më të qartë për kapacitetet teknike dhe profesionale që zotërojnë operatorët ekonomik në mënyrë të tillë që të provojnë dhe të garantohen se këto të fundit zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Megjithatë, pavarësisht qëllimit kryesor të autoritetit kontraktor që të provojë dhe të garantohet se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, **vlerësojmë se autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesa proporcionale në varësi të volumit si dhe të natyrës së kontratës duke u bazuar në një analizë të detajuar në mënyrë të tillë që të rrisë konkurrencën dhe të maksimizojë efikasitetin e procedurës së prokurimit.**



10

12

Në rastin konkret pasi morëm në kriterin e mësipërm konstatojmë se kërkesa që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dorëzojnë *“kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se: Vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.”* **është një kërkesë e ekzagjuar dhe jo në proporcion me volumin e procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe si e tillë nuk qëndron.**

Vlerësojmë se autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e dokumentave të tenderit bazuar ndër të tjera edhe në parimin e proporcionalitetit dhe në rastin konkret në lidhje me kërkesën e mësipërme gjykojmë se autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar këtë parim.

Duke marrë në shqyrtim dokumentat standarte të tenderit në tërësi konstatojmë se autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dorëzojnë furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e fondit limit ndërsa përsa i përket xhiros vjetore të tre viteve të fundit ka kërkuar që ajo të jetë sa fondi limit i procedurës së prokurimit, pra në gjykimin tonë autoriteti kontraktor nuk ka vepruar në koherencë në hartimin e kriterëve si një e tërë.

Qëllimi i autoritetit kontraktor gjatë fazës së hartimit të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit” është që nëpërmjet kërkesave të kërkuara, autoriteti kontraktor të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë kapacitetet e nevojshme, besueshmërinë si dhe përvojën e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës dhe në rastin konkret gjykojmë se autoriteti kontraktor mund të garantohet se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës edhe nëpërmjet kërkit të një vlere më të vogël sa fondi limit i procedurës së prokurimit përsa i përket xhiros vjetore të tre viteve të fundit.

Vlerësojmë se, në këtë mënyrë autoriteti kontraktor jo vetëm që do ishte në koherencë në hartimin e dokumentave standarte të tenderit në tërësi dhe do të garantohej për



11

13

kapacitetet e operatorëve ekonomikë për realizimin me sukses të kontratës por në të njëjtën kohë nëpërmjet kërkesës për disponimin e një % më të vogël se ajo e kërkuar përsa i përket xhiros vjetore të tre viteve të fundit, autoriteti kontraktor do të rriste konkurrencën dhe efikasitetin e procedurës së prokurimit objekt ankimi pasi do të garantonte gjithëpërfshirjen e operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, kërkojmë modifikimin e kriterit të mësipërm duke kërkuar disponimin e "kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.", dhe në gjykimin tonë disponimi i një vlere sa 40% e vlerës së përlogaritur e kontratës objekt prokurimi" do të ishte një kërkesë në proporcion me volumin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

2. Në shtojcën 7 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", "Kapaciteti teknik" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se: "4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës, në funksion të përmbushjes me sukses të kontratës duhet të vërtetojnë se disponojnë personel të kualifikuar, si më poshtë :

- Te pakten një Inxhinier tekstil
- Të pakten një Stilist / modelist

Per sa me sipër operatorët ekonomike duhet të paraqesin : Kontrate pune, diplomë universitare për inxhinierin tekstil, të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, kontrate pune, CV .

Për punonjësin Silist/Modelist Kontratë pune,CV, dokument që të vërtetojnë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikate), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licensuara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. Personeli i kualifikuar duhet të jetë pjesë e përvijës së ofertuesit dhe për këtë OE duhet të deshmojnë se kanë patur në listpagesat e shoqërisë të pakten muajin e fundit.



12
[Handwritten signature]
19

Në nenin 2 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", parashikohet se:

"Qëllim i këtij ligji është:

- e) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- f) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- g) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- h) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."

Në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet se:

"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

4. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

5. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në



legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.”

Në nenin 77, pika 1 dhe 4 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

6. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.



14

16

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 82 **“Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”**, të LPP-së përcaktohet se:

- “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*
- 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*
- 3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.*
- 4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.*
- 5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:*
 - a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit*



pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”

Në nenin 26, pika 1 dhe gërma “h” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti)”;

Në nenin 40 pika 5 gërma “c” e Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës ; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit

16



ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe **personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.** Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim në varësi të volumit sidhe të natyrës së kontratës, me qëllimin e krijimit të një panorame sa më të qartë për kapacitetet teknike dhe profesionale që zotërojnë operatorët ekonomik në mënyrë të tillë që të provojnë dhe të garantohen se këto të fundit zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Megjithatë, pavarësisht qëllimit kryesor të autoritetit kontraktor që të provojë dhe të garantohet se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, vlerësojmë se autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesa proporcionale në varësi të volumit si dhe të natyrës së kontratës duke u bazuar në një analizë të detajuar në mënyrë të tillë që të rrisë konkurrencën dhe të maksimizojë efijencën e procedurës së prokurimit.



Në rastin konkret pasi morëm në shqyrtim dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi, "Kriteret e Veçanta të kualifikimit", "Specifikimet teknike", shtojcën 2 "Lista e çmimeve të artikujve" ku parashikohet sasia e kërkuar e mallrave objekt prokurimi, si dhe "Procesverbalin e argumentimit", vlerësojmë se kërkesa për disponueshmërinë e "të paktën një Inxhinier tekstil dhe të paktën një Stilist / modelist të cilët duhet të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë per të paktën muajin e fundit" është një kërkesë e cila dëmton garën dhe efikasitetin e procedurës së prokurimit dhe që bie ndesh me ligjin "Për Prokurimin Publik", me aktet nënligjore në zbatim të tij, me rekomandimet drejtuar autoriteteve kontraktore nga "Agjencia e Prokurimit Publik", dhe gjithashtu dhe me praktikën e rasteve të ngjashme të "Komisionit të Prokurimit Publik".

Në një interpretim literal dhe sistematik të nenit 77, pika 4 të ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", konstatojmë se në hartimin e kërkesave të veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor duhet të garantohet se operatorët ekonomikë në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit zotërojnë kapacitetet e nevojshme njerëzore në funksion të realizimit me sukses të kontratës, dhe kërkesa që "operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën një Inxhinier tekstil dhe të paktën një Stilist / modelist të cilët duhet të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë per të paktën muajin e fundit" është një kërkesë e ekzagjeruar e cila nuk i shërben qëllimit final të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër, gjykojmë se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është të deklarohet disponueshmëria e kapaciteteve të nevojshme njerëzore në momentin e ofertimit, dhe të vërtetohet disponueshmëria e tyre në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, pa qenë e nevojshme të kërkohet disponueshmëria e stafit të mësipërm per të paktën muajin e fundit.

Vlerësojmë se për përmbushjen e qëllimit final të krijimit të bindjes që operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës për



autoritetin kontraktor mjafton që operatorët ekonomikë të disponojnë burimet e nevojshme njerëzore për përmbushjen me sukses të kontratës në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit dhe përpara lidhjes së kontratës si dhe për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës , dhe rrjedhimisht kërkesa për disponueshmërinë e këtij stafi per të paktën muajin e fundit është një kërkesë e cila ul konkurrencën dhe efijencën e procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe për më tepër nuk i shërben qëllimit final të realizimit me sukses të kontratës.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Agjencia e Prokurimit Publik në rekomandimin Nr.6732 Prot, datë 21.10.2020 "Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të dokumenteve të tenderit dhe verifikimit të procedurave të prokurimit për mallra, punë, shërbime", ku ndër të tjera në pikën 5 të të cilit ka rekomanduar autoritetet kontraktore se: [...Për AK, e rëndësishme është të vërtetohet disponimi i punonjësve të kërkuar në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurimi...]"

Gjithashtu të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik në një rast të ngjashëm ose më specifikisht për të njëjtën procedurë të publikuar nga autoriteti kontraktor "Illyrian Guard" në Vendimin Nr.32/2023 ku ndër të tjera KPP ka arsyetuar se : [...“Një nga qëllimet e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. KPP vlerëson, se në rastin konkret, bindja e autoritetit kontraktor, se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin me sukses të kontratës, duke pasur në konsideratë objektin dhe volumnin e kontratës, nuk kushtëzohet me figurimin e tyre në listëpagesa për një periudhë të caktuar, por nëmomentin e zhvillimit të procedurës. ...]"



Sa më sipër kërkojmë modifikimin e kriterit të mësipërm pasi gjykojmë se është një kriter i ekzagjeruar ,diskriminues dhe jo proporcional me natyrën dhe vëllimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe si i tillë dëmton konkurrencën dhe efikasitetin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke kërkuar që ti krijohet mundësia operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të deklarojnë fillimisht stafin që do të angazhohet në realizimin e kontratës dhe vetëm në rast të shpalljes fitues operatori ekonomik i renditur i pari të provojë disponueshmërinë e atij stafi në momentin e shpalljes fitues dhe përpara lidhjes së kontratës.

Së dyti, pasi morëm në shqyrtim kriterin e mësipërm konstatojmë se autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar mundësinë për përmbushjen e këtij kriteri në momentin e ofertimit nëpërmjet dorëzimit të shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”.

Në rastin konkret, bazuar në ligjin “Për Prokurimin Publik” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij si dhe bazuar në qëllimet për të cilat kërkohet plotësimi dhe dorëzimi i këtij formulari, për të evituar çdo paqartësi ose interpretim që mund të lindë në fazën e vlerësimit kërkojmë që të parashikohet shprehimisht se në fazën e ofertimit ky kriter mund të përmbushet nëpërmjet dorëzimit të shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” dhe në momentin e vlerësimit dhe përpara shpalljes së njoftimit të fituesit të dorëzohen dokumentat provuese nga operatori ekonomik i renditur i pari.

Sa më sipër kërkojmë:

- 1. Pranimin e ankesës ;**
- 2. Modifikimin e kriterëve objekt ankimi.**



20

22

5. Kërkesë për ekspertizë të posacme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Nuk kemi asnjë kërkesë

7. Lista e informacionit konfidencial:

N/A

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar

Armand Sinani

Armand Sinani

[Signature]

21



23